



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

**RREGULLORE (ZKM) NR. 03/2024 PËR ORGANIZIMIN E
BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË
SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS¹**

¹Rregullore (ZKM) Nr.03/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Sprovues të Kosovës, është miratuar nga Kryeministri me Vendimin Nr. 016/2024, të dates 14.02.2024.

Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 94 (10) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 28 (paragrafi 3) të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 9 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.11) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në përputhje me nenin 8 dhe 9 të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura,

Miraton:

REGULLORE (ZKM) NR. 03/2024 PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM DHE SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN SPROVUES TË KOSOVËS

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është përcaktimi i organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës në Shërbimin Sprovues të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: SHSK).

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për SHSK-në.
2. Fusha e përgjegjësisë është përcaktuar në Ligjin nr. 08/L-129 për Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 3 Misioni

Misioni i Shërbimit Sprovues të Kosovës është ngritja e vetëdijes shoqërore duke bashkëpunuar me të gjitha organet e pushtetit shtetëror për humanizmin e ekzekutimit të dënimeve alternative, reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë për shoqërinë tonë.

KAPITULLI II ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE FUNKSIONIMI

Neni 4

Struktura organizative e Shërbimit Sprovues të Kosovës

1. Struktura organizative e Shërbimit Sprovues të Kosovës është si vijon:

1.1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv;

1.2. Departamentet;

1.3. Divizionet.

2. Numri i të punësuarve në këtë agjenci ekzekutive është tetëdhjetënjë (81).

Neni 5

Zyra e Drejtorit Ekzekutiv

1. Zyra e Drejtorit ekzekutiv të Shërbimit Sprovues të Kosovës përbëhet nga:

1.1. Drejtori Ekzekutiv;

1.2. Zyrtari i Lartë për Certifikim;

1.3. Një (1) Zyrtar i Lartë Ekzekutiv;

1.4. Një (1) Zyrtar Administrativ.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv, përcaktohen me Ligjin për Shërbimin Sprovues Nr. 08/L-129 dhe legjislacionin përkatës në fuqi për zyrtarët publik.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të lartë për certifikim, përcaktohen me legjislacionin përkatës në fuqi për zyrtarët publik.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrtarit të lartë ekzekutiv dhe të Zyrtarit administrativ, përcaktohen me legjislacionin përkatës në fuqi për zyrtarët publik.

5. Numri i të punësuarve në Zyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Shërbimit Sprovues të Kosovës është katër (4).

Neni 6

Departamentet dhe Divizionet në kuadër të Shërbimit Sprovues të Kosovës

1. Departamenti për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative:

- 1.1.Divizioni për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për të mitur;
- 1.2.Divizioni për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për madhor.
2. Departamenti për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe:
 - 2.1.Divizioni për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht;
 - 2.2.Divizioni për mbikëqyrje të posaçme dhe programe.
3. Departamenti për Shërbime të Përgjithshme:
 - 3.1.Divizioni për administrimin e shërbimeve të përgjithshme;
 - 3.2.Divizioni për teknologji informative dhe bazës së të dhënave.
4. Divizioni për Buxhet dhe Financa.
- 5.Divizioni për Menaxhimin e Burimeve njerëzore.
6. Divizioni Rajonal, Prishtinë.
7. Divizioni Rajonal, Prizren.
8. Divizioni Rajonal, Mitrovicë.
9. Divizioni Rajonal, Pejë.
10. Divizioni Rajonal, Gjiilan.
11. Divizioni Rajonal, Ferizaj.
12. Divizioni Rajonal, Gjakovë.

Neni 7

Departamenti për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të Masave dhe Dënimeve Alternative

1. Misioni i Departamentit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative është mbikëqyrja e zbatimit të masave dhe dënimeve Alternative, si dhe hartimi dhe zbatimi i politikave programore dhe standardeve të punës për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative janë:
 - 2.1.Bënë zbatimin e politikave programore dhe standardeve të punës për ekzekutimin e masave, dënimeve alternative, hartimin e anketave sociale dhe raporteve para ndëshkuese;

- 2.2. Monitoron punën e Divizioneve Rajonale lidhur me përgatitjen e raporteve për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative;
 - 2.3. Mbikëqyrë zbatimin e programeve për risocializimin dhe re-integrimin në shoqëri të personave të dënuar me dënime alternative;
 - 2.4. Ofron këshilla dhe mbështetje për divizionet rajonale për ekzekutimin e masave, dënimeve alternative, hartimin e anketave sociale dhe raporteve para ndëshkuese;
 - 2.5. Siguron bashkërendimin e programeve të punës për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative me institucionet tjera relevante;
 - 2.6. Ofron mbështetje në hartimin e programeve të trajnimit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët sprovues në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative;
 - 2.7. Menaxhon regjistrin elektronik të të dhënave (data-bazës) së SHSK-së;
 - 2.8. Harton raporte lidhur me zbatimin e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative;
 - 2.9. Harton raporte të javore, mujore, periodike dhe vjetore për punën e departamentit;
 - 2.10. Promovon masat dhe dënimet alternative.
3. Drejtori i Departamentit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.
 4. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë divizionet si vijon:
 - 4.1. Divizioni për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për të mitur;
 - 4.2. Divizioni për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për madhorë.
 5. Numri i të punësuarve në Departamentin për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative është shtatë (7).

Neni 8

Divizioni për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të Masave dhe Dënimeve Alternative për të Mitur

1. Misioni i Divizionit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për të mitur është mbikëqyrja e zbatimit të masave dhe dënimeve Alternative për të mitur, si dhe hartimi dhe zbatimi i politikave programore dhe standardeve të punës për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për të mitur janë:

- 2.1. Zbaton politikat programore dhe standardet e punës në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur si dhe përkujdeset pas lirimit të tyre nga burgu;
 - 2.2. Monitoron punën në mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, hartimin e anketave sociale dhe raporteve para ndëshkuese për të mitur;
 - 2.3. Përcjellë zbatimin e programeve për risocializimin dhe re-integrimin në shoqëri të personave të mitur me masa dhe dënime alternative;
 - 2.4. Siguron bashkërendimin e programeve të punës me institucionet tjera relevante, për persona të mitur me masa dhe dënime alternative;
 - 2.5. Ofron mbështetje në hartimin e programeve të trajnimit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët sprovues në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur;
 - 2.6. Menaxhon regjistrin elektronik të të dhënave (data-bazës) së SHSK-së dhe harton raporte mbi ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur;
 - 2.7. Harton raporte lidhur me punën mbi ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për të mitur si dhe raporte për punën e Divizionit për të mitur.
3. Udhëheqësi i Divizionit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për të mitur raporton tek Drejtori i Departamentit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për të mitur është tre (3).

Neni 9

Divizioni për Mbikëqyrjen e Ekzekutimit të Masave dhe Dënimeve Alternative për Madhor

1. Misioni i Divizionit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për madhor është mbikëqyrja e zbatimit të masave dhe dënimeve Alternative për madhor, si dhe hartimi dhe zbatimi i politikave programore dhe standardeve të punës për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për madhorë janë:
 - 2.1. Zbaton politikat programore dhe standardet e punës në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për persona madhor;
 - 2.2. Bënë mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative, si dhe hartimin e raporteve para shqiptimit të dënimit për persona madhor;
 - 2.3. Përcjellë zbatimin e programeve për risocializimin dhe re-integrimin në shoqëri për persona madhor të dënuar me masa dhe dënime alternative;

- 2.4.Siguron bashkërendimin e programeve të punës me institucionet tjera relevante, për persona madhor të dënuar me masa dhe dënime alternative;
 - 2.5.Bënë hartimin e programeve të trajnimit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët sprovues, në ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor;
 - 2.6.Menaxhon regjistrin elektronik të të dhënave së SHSK-së dhe harton raporte mbi ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor;
 - 2.7.Harton raporte mbi ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor si dhe raporte tjera që lidhen me punën e Divizionit për madhor.
- 3.Udhëheqësi i Divizionit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për persona madhorë raporton tek Drejtori i Departamentit për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative.
 - 4.Numri i të punësuarve në Divizionin për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative për persona madhorë është tre (3).

Neni 10

Departamenti për Mbikëqyrjen e të Liruarve me Kusht, Mbikëqyrje të Posaçme dhe Programe

- 1.Misioni i Departamentit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe është zhvillimi, udhëheqja dhe koordinimi i politikave të mbikëqyrjes, korrektimit dhe ri-integrimit në shoqëri të personave të liruar me kusht nga burgu, atyre me mbikëqyrje të veçantë, si dhe zbatimin dhe implementimin e programeve adekuate për persona të caktuar.
- 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe janë:
 - 2.1.Bën zbatimin e politikave programore dhe standardeve të punës për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri si dhe persona me mbikëqyrje të posaçme;
 - 2.2.Bën monitorimin e programeve për risocializimin dhe të ri-integrimit të personave të liruar me kusht nga burgu dhe personave me mbikëqyrje të posaçme;
 - 2.3.Monitoron punën e Divizioneve Rajonale në ri-socializimin personave të liruar me kusht nga burgu, si dhe të personave me mbikëqyrje të posaçme;
 - 2.4.Siguron bashkërendimin e programeve të punës me institucionet tjera relevante, për persona të liruar me kusht nga burgu dhe personave me mbikëqyrje të posaçme;
 - 2.5.Bënë hartimin e programeve të trajnimit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët sprovues, në mbikëqyrjen të personave të liruar me kusht nga burgu persona me mbikëqyrje të posaçme;
 - 2.6.Mundëson sigurimin e programeve adekuate me qëllim të Ri-socializimit dhe rehabilitimit për persona të liruar me kusht nga burgu të personave me mbikëqyrje të posaçme;

2.7. Pranon dhe shqyrton kërkesat e personave të liruar me kusht në bashkëpunim me panelin për lirim me kusht si dhe kërkesat e personave lidhur me veprat për terrorizëm dhe radikalizëm në bashkëpunim me Drejtorin Ekzekutiv të Shërbimit Sprovues të Kosovës;

2.8. Bënë vlerësimin dhe verifikim e nevojave të personave të liruar me kusht dhe atyre me mbikëqyrje të posaçme;

2.9. Bashkëpunon dhe bashkërendon veprimet me Panelin për Lirim me Kusht.

3. Drejtori i Departamentit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

4. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë:

4.1. Divizioni për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht;

4.2. Divizioni për mbikëqyrje të posaçme dhe programe.

5. Numri i të punësuarve në Departamentin për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe është shtatë (7).

Neni 11

Divizioni për Mbikëqyrjen e të Liruarve me Kusht

1. Misioni i Divizionit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht është të zbatoj politika për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu lidhur me risocializimin dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht janë:

2.1. Përcjell zbatimin e politikave programore dhe standardeve të punës për mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu;

2.2. Mbikëqyrë zbatimin e programeve për risocializimin dhe re-integrimin në shoqëri të personave të liruar me kusht;

2.3. Vlerëson nevojat e trajnimit për zyrtarët e Shërbimit Sprovues, si dhe për personat që janë nën mbikëqyrje të Shërbimit Sprovues;

2.4. Harton raporte mbi mbikëqyrjen e personave të liruar me kusht nga burgu për nevojat e Shërbimit Sprovues;

2.5. Bashkëpunon, pranon dhe adreson te paneli për lirim me kusht kërkesat e personave të liruar me kusht nga të gjitha divizionet rajonale.

3. Udhëheqësi i Divizionit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht raporton tek Drejtori i Departamentit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht është tre (3).

Neni 12
Divizioni për Mbikëqyrje të Posaçme dhe Programe

1.Misioni i Divizionit për Mbikëqyrje të Posaçme dhe Programe është mbikëqyrja dhe koordinimi i punës në Divizionin për mbikëqyrje të posaçme dhe programe në risocializimit dhe ri integrimin e personave të liruar me kusht për mbikëqyrje të posaçme si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi i Divizioneve Rajonale, Panelin e Lirimit me Kusht, SHKK-në, me Ministrinë e linjës si dhe me OJQ-të nga fusha përkatëse.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për mbikëqyrje të posaçme dhe programe janë:

2.1.Ekzekuton vendimet dhe kërkesat e organeve gjyqësore për personat më mbikëqyrje të posaçme;

2.2.Organizon dhe koordinon procesin mbikëqyrës të personave nën mbikëqyrje të posaçme;

2.3.Mbështet ri-integrimin dhe ri-socializimin e personave nën mbikëqyrje të posaçme;

2.4.Koordinon punën me akterët relevantë si dhe organet gjyqësore sa i përket realizimit të mbikëqyrjes së posaçme;

2.5.Ofron mbështetje profesionale për zyrtarët sprovues lidhur me realizimin e kërkesave të tyre për risocializim dhe ri-integrimin në shoqëri të personave të liruar me kusht me mbikëqyrje të posaçme;

2.6.Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje të posaçme;

2.7.Zbaton politikat e departamentit si dhe Panelit për Lirim me Kusht lidhur me trajtimin e personave të liruar me kusht me mbikëqyrje të posaçme;

2.8.Ofron programe dhe projekte të cilat do të ndikojnë në profesionalizimin e zyrtarëve sprovues duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha divizionet rajonale si dhe institucionet e tjera relevante;

2.9.Harton dhe mbikëqyrë zbatimin e planit individual të mbikëqyrjes duke marrë për bazë rrezikun për përsëritje të veprës të personave nën mbikëqyrje të posaçme;

2.10. Harton raportet lidhur me aktivitetin e divizionit.

3.Udhëheqësi i Divizionit për mbikëqyrje të posaçme dhe programe raporton tek Drejtori i Departamentit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe.

4.Numri i të punësuarve në Divizionin për mbikëqyrje të posaçme dhe programe është tre (3).

Neni 13
Departamenti për Shërbime të Përgjithshme

1.Misioni i Departamentit për shërbime të përgjithshme është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe ofrimi i shërbimeve tjera të nevojshme për mbështetje administrative dhe logjistike, transporti, teknologji informative, arkivës dhe bashkëpunon me të gjitha institucionet e SHSK-

së gjithmonë duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret në fuqi mbi regjistrimin e pasurive dhe aseteve.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Shërbime të përgjithshme janë:

2.1.Menaxhon dhe mirëmban informatat për inventarë dhe depo, si dhe ofron mbështetje administrative dhe të logjistikës;

2.2.Bënë zbatimin e procedurave për menaxhimin me të gjitha automjetet që disponon SHSK, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.3.Menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të SHSK;

2.4.Bënë furnizime me të gjithë artikujt e nevojshëm të logjistikës, si furnizim me material të ndryshëm për nevoja të stafit;

2.5.Bënë mbështetje në fushën e teknologjisë informative, mirëmban pajisjet e teknologjisë informative si dhe ofron shërbime të teknologjisë informative;

2.6.Administron bazën e të dhënave për SHSK-në dhe kujdeset për përditësimin dhe avancimin e sistemit të bazës së të dhënave;

2.7.Planifikon dhe bënë regjistrimin, organizimin dhe shpërndarjen e gjithë aseteve;

2.8.Drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

2.9.Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë divizionet, si në vijim:

2.10.Divizioni për administrimin e shërbimeve të përgjithshme.

3.Divizioni për Teknologji Informative (TI) dhe bazës së të dhënave.

4.Numri i të punësuarve në Departamentin për shërbime të përgjithshme është shtatë (7).

Neni 14

Divizioni për Administrimin e Shërbimeve të Përgjithshme

1.Misioni i Divizionit për administrimin e shërbimeve të përgjithshme është ofrimi i shërbimeve profesionale dhe ofrimi i shërbimeve tjera të nevojshme për mbështetje administrative dhe logjistike, menaxhim transporti, arkivën e Shërbimit Sprovues të Kosovës.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për administrimin e shërbimeve të përgjithshme janë:

2.1.Siguron dhe mirëmban informatat për inventarë dhe depo, si dhe ofron mbështetje administrative dhe të logjistikës;

2.2.Bënë zbatimin e procedurave për menaxhimin me të gjitha automjetet që disponon SHSK, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.3.Mirëmban dhe kujdeset për sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme të SHSK;

2.4. Menaxhon, bënë përgatitjen për furnizime me të gjithë artikujt e nevojshëm të logjistikës, si furnizim me material të ndryshëm për nevoja të stafit;

2.5. Planifikon, Siguron dhe bënë regjistrimin, organizimin dhe shpërndarjen e gjithë aseteve.

3. Udhëheqësi i Divizionit për administrimin e shërbimeve të përgjithshme raporton tek Drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Administrimin e Shërbimeve të Përgjithshme është tre (3).

Neni 15

Divizioni për Teknologji Informative (TI) dhe Bazës së të dhënave

1. Misioni i Divizionit për Teknologji Informative (TI) dhe Bazës së të Dhënave është ofrimi i shërbimeve profesionale për mbështetje në teknologji informative për Shërbimin Sprovues, si dhe administrimin e bazës së të dhënave.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Teknologji Informative (TI) dhe bazës së të dhënave janë:

2.1. Ofron shërbime profesionale dhe të cilësisë nga fusha e teknologjisë informative në SHSK, përfshirë lidhjen në rrjet, qasjen në Internet, e-mail, etj;

2.2. Harton specifikat e ndryshme për furnizime e servisime për pajisje të teknologjisë informative përfshirë edhe të serverëve;

2.3. Menaxhon mirëmbajtjen e kompjuterëve dhe softuerit në SHSK, sistemin telefonik dhe ndërmerr masa për problemet apo ankesat eventuale të shfrytëzuesve në kohë;

2.4. Menaxhon bazën e të dhënave për SHSK-në dhe bënë përditësimin dhe avancimin e sistemit të bazës së të dhënave;

2.5. Mirëmban dhe ndërmerr masa lidhur me problemet që shfaqen apo ankesat që adresohen nga shfrytëzuesit në sistemin e bazës së të dhënave në SHSK-së.

3. Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative (TI) dhe bazës së të dhënave raporton tek Drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për Teknologji Informative (TI) dhe Bazës së të dhënave është tre (3).

Neni 16

Divizioni për Buxhet dhe Financa

1. Misioni i Divizionit për buxhet dhe financa është kryerja e punëve profesionale në lëmine e shpenzimeve të të gjitha kategorive ekonomike, si dhe ofrimi i shërbimeve tjera të nevojshme lidhur me punët në Buxhet dhe Financa.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për buxhet dhe financat janë:

2.1. Mbikëqyrë zbatimin e politikave dhe procedurave standarde, ligjet në fuqi dhe rregulloret që lidhen me fushën e buxhetit dhe financave të SHSK-së dhe sigurohet që rekomandimet e auditimit në fushën e financave të jenë prioritet;

2.2. Përgatit Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, planifikimin buxhetor për Agjencinë SHSK-në në përgatitjen e KASH-it, dhe kërkesave buxhetore (planifikimin buxhetor);

2.3. Kujdeset për rishikimin e buxhetit duke u bazuar në kërkesat e strukturës organizative të SHSK-së për ridestininim të mjeteve nga një kategori ekonomike në kategori tjetër sipas ligjeve në fuqi;

2.4. Përcjellë dhe raporton mbi ekzekutimin e buxhetit, siguron që shpenzimet financiare janë bërë në përputhje me rregullat dhe procedurat buxhetore;

2.5. Menaxhon rezervat e parasë dhe siguron se kontrolli i brendshëm financiar është i bazuar në parimet e llogaridhënies;

2.6. Analizon dhe vlerëson proceset dhe procedurat e brendshme të buxhetit.

3. Udhëheqësi i Divizionit për buxhet dhe financa raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin për buxhet dhe financa është tre (3).

Neni 17

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

1. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (DMBNJ) është njësi organizative në kuadër të SHSK, i cili ka për mision të sigurojë menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në shpërndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në mënyrë të balancuar për nëpunësit e institucionit.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore janë:

2.1. Analizon nevojat e punësimit dhe zhvillon planin e personelit;

2.2. Udhëheqë, planifikon, mbikëqyrë dhe koordinon punët e njësive organizative në të gjitha aktivitetet e njësive të burimeve njerëzore dhe siguron funksionim efikas;

2.3. Bën organizimin dhe menaxhimin e të gjitha trajnimeve të ofruara nga Akademia për Siguri Publike, Instituti i Kosovës për Administratë Publike dhe organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare;

2.4. Harton planin e trajnimeve dhe monitoron zbatimin e tij në bazë të nevojave të përcaktuara nga njësit e tjera organizative;

2.5. Ushtron kompetenca në përputhje me autorizimet dhe përgjegjësitë në funksion të zbatimit të legjislacionit, dokumenteve, kërkesave, procedurave, standardeve për institucionin në fushën e burimeve njerëzore;

- 2.6.Harton planin vjetor dhe planin afatmesëm të personelit, në pajtim me procesin e planifikimit buxhetor të institucionit;
- 2.7.Zbaton procedurën e rekrutimit dhe ofron mbështetje profesionale dhe administrative komisionit përzgjedhës në bazë të legjislacionit në fuqi;
- 2.8.Ndihmon njësitë përkatëse në përgatitjen e përshkrimit të vendeve të punës, klasifikimin e vendeve të punës dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- 2.9.Siguron zbatimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë, pushimet, trajnimet, vijueshmërinë në punë, procedurat disiplinore, pezullimin e marrëdhënies së punës, përfundimin e marrëdhënies së punës – lirimin nga shërbimi civil, pensionimin e parakohshëm, vërtetimet, statistikat e të punësuarve në bazë të akteve ligjore në fuqi.
- 3.Udhëheqësi i Divizionit për menaxhimin burimeve njerëzore raporton te Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.
- 4.Numri i të punësuarve në Divizionin për menaxhimin e burimeve njerëzore është tre (3).

Neni 18

Divizioni Rajonal Prishtinë

- 1.Misioni i Divizionit Rajonal Prishtinë është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionin rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, ri-socializimin dhe ri-edukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruar me kusht nga burgu.
- 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal Prishtinë janë:
- 2.1.Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;
- 2.2.Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;
- 2.3.Mbështet dhe re- integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;
- 2.4.Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;
- 2.5.Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal Prishtinë për nevojat e SHSK;
- 2.6.Përgatitë anketa sociale, raport parandëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;
- 2.7.Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruarve me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;

- 2.8.Harton planin individual të mbikëqyrjes;
 - 2.9.Koordinon aktivitetet me institucionet relevant për programin e përkujdesjes së pas lirimit nga burgu;
 - 2.10.Bashkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;
 - 2.11.Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e lirimit me kusht etj.
 - 2.12.Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;
 - 2.13.Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;
 - 2.14.Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht.
- 3.Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Prishtinë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.
 - 4.Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal Prishtinë është trembëdhjetë (13).

Neni 19

Divizioni Rajonal Prizren

- 1.Misioni i Divizionit Rajonal Prizren është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionit rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, risocializimin dhe riedukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruuar me kusht nga burgu.
- 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal në Prizren janë:
 - 2.1.Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;
 - 2.2.Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;
 - 2.3.Mbështet dhe re- integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;
 - 2.4.Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje
 - 2.5.Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal Prizren për nevojat e SHSK;

- 2.6.Përgatitë anketa sociale, raport para ndëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;
- 2.7.Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruave me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;
- 2.8.Harton planin individual të mbikëqyrjes;
- 2.9.Koordinon aktivitete me institucionet relevant për programin e përkujdesjes së pas lirit nga burgju;
- 2.10.Bashkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;
- 2.11.Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e lirit me kusht etj.
- 2.12.Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;
- 2.13.Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;
- 2.14.Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht.
- 3.Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Prizren raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.
- 4.Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal Prizren është shtatë (7).

Neni 20

Divizioni Rajonal Mitrovicë

- 1.Misioni i Divizionit Rajonal, Mitrovicë është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionin rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, risocializimin dhe riedukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruave me kusht nga burgju.
- 2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal në Mitrovicë janë:
- 2.1.Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;
- 2.2.Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;
- 2.3.Mbështet dhe re-integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;
- 2.4.Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit

individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;

2.5.Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal Mitrovicë për nevoja të SHSK;

2.6.Përgatitë anketa sociale, raport para ndëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;

2.7.Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruave me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;

2.8.Harton planin individual të mbikëqyrjes;

2.9.Koordinon aktivitete me institucionet relevant për programin e përkujdesjes së pas lirit nga burgju;

2.10.Bashkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;

2.11.Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e lirit me kusht etj.

2.12.Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;

2.13.Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;

2.14.Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht.

3. Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Mitrovicë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal në Mitrovicë është gjashtë (6).

Neni 21 **Divizioni Rajonal Pejë**

1.Misioni i Divizionit Rajonal Pejë është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionin rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, risocializimin dhe riedukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruave me kusht nga burgju.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal në Pejë janë:

2.1.Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;

2.2.Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;

- 2.3.Mbështet dhe re- integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;
- 2.4.Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;
- 2.5.Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal Pejë për nevojat e SHSK;
- 2.6.Përgatitë anketa sociale, raport para ndëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;
- 2.7.Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruarve me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;
- 2.8. Harton planin individual të mbikëqyrjes;
- 2.9.Koordinon aktivitete me institucionet relevante për programin e përkujdesjes së pas lirit nga burg;
- 2.10.Bashkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;
- 2.11.Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e lirit me kusht etj.
- 2.12.Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;
- 2.13.Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;
- 2.14.Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht;
- 3.Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Pejë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.
- 4.Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal në Pejë është 6 (gjashtë).

Neni 22

Divizioni Rajonal Gjilan

1. Misioni i Divizionit Rajonal Gjilan është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionin rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, risocializimin dhe riedukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruar me kusht nga burg.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal në Gjilan janë:

- 2.1. Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;
 - 2.2. Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;
 - 2.3. Mbështet dhe re- integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;
 - 2.4. Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;
 - 2.5. Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal në Gjilan për nevojat e SHSK;
 - 2.6. Përgatitë anketa sociale, raport para ndëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;
 - 2.7. Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruarve me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;
 - 2.8. Harton planin individual të mbikëqyrjes;
 - 2.9. Koordinon aktivitete me institucionet relevante për programin e përkujdesjes së pas liritimit nga burgu;
 - 2.10. Bashkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;
 - 2.11. Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e liritimit me kusht etj.
 - 2.12. Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;
 - 2.13. Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;
 - 2.14. Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht.
3. Udhëheqësi i Divizionit Rajonal në Gjilan raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.
 4. Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal Gjilan është 6 (gjashtë).

Neni 23 **Divizioni Rajonal Ferizaj**

1. Misioni i Divizionit Rajonal Ferizaj është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionin rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, risocializimin dhe riedukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me

masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruar me kusht nga burgu.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal në Ferizaj janë:

2.1. Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;

2.2. Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;

2.3. Mbështet dhe ri-integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;

2.4. Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;

2.5. Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal në Ferizaj për nevojat e SHSK;

2.6. Përgatitë anketa sociale, raport para ndëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;

2.7. Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruarve me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;

2.8. Harton planin individual të mbikëqyrjes;

2.9. Koordinon aktivitete me institucionet relevante për programin e përkujdesjes së pas lirimit nga burgu;

2.10. Bashkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;

2.11. Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e lirimit me kusht etj.

2.12. Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;

2.13. Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;

2.14. Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht.

3. Udhëheqësi i Divizionit Rajonal në Ferizaj raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

4. Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal në Ferizaj është 6 (gjashtë).

Neni 24
Divizioni Rajonal Gjakovë

1.Misioni i Divizioni Rajonal Gjakovë është menaxhimi dhe koordinimi i punëve në divizionin rajonal të Shërbimit Sprovues. Planifikimi i dënimit për korrektimin, risocializimin dhe riedukimin shoqëror të personave që kanë rënë ndesh me ligjin dhe janë të sanksionuar me masa dhe dënime alternative. Po ashtu mbikëqyrja dhe re-integrimi në shoqëri i personave të liruar me kusht nga burgu.

2.Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit Rajonal në Gjakovë janë:

2.1.Ekzekuton vendimet e organeve gjyqësore;

2.2.Organizon koordinimin e procesit të mbikëqyrjes të personave në mbikëqyrje;

2.3.Mbështet dhe re- integron personat nën mbikëqyrje dhe koordinon punët me institucionet relevante si dhe organet gjyqësore;

2.4.Harton raporte të vlerësimit për personat nën mbikëqyrje dhe raporton tek organet gjyqësore dhe institucionet tjera relevante, si dhe mbikëqyrë mënyrën e zbatimit të planit individual të mbikëqyrjes duke marr për bazë rrezikun dhe nevojat e personave nën mbikëqyrje;

2.5.Harton raporte të rregullta mbi aktivitetin e Divizionit Rajonal në Gjakovë për nevoja të SHSK;

2.6.Përgatitë anketa sociale, raport para ndëshkues dhe përfaqëson seancat gjyqësore sipas ftesave të pranuar nga Gjykata;

2.7.Zbaton masat e diversitetit, masat edukative, dënimet alternative për të mitur dhe të liruarve me kusht në bazë të Kodit të drejtësisë për të mitur;

2.8.Harton planin individual të mbikëqyrjes;

2.9.Koordinon aktivitete me institucionet relevante për programin e përkujdesjes së pas lirimit nga burgu;

2.10.shkëpunon me institucionet në komunitet për ekzekutimin e vendimeve të organeve gjyqësore;

2.11.Hartimin e raporteve të ndryshme për prokurori, gjykata, panelin e lirimit me kusht etj.

2.12.Përgatit raportin para shqiptimit të dënimit për madhor sipas kërkesave nga organet gjyqësore;

2.13.Realizon masat dhe dënimet alternative në bazë të legjislacionit në fuqi dhe aplikon programe të ndryshme në punën me të dënuarit me masa dhe dënime alternative;

2.14.Realizon procedurat për nënshkrim të deklaratës premtuese për të dënuarit të cilët aplikojnë për lirim me kusht dhe ekzekuton vendimet e Panelit për lirim me kusht;

3.Udhëheqësi i Divizionit Rajonal në Gjakovë raporton tek Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

4.Numri i të punësuarve në Divizionin Rajonal në Gjakovë është gjashtë (6).

KAPITULLI III DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25 Dispozitat kalimtare

1.Pozitat e reja udhëheqëse në kuadër të SHSK-së rekrutohen në pajtim me dispozitat e legjislacionit përkatës në fuqi.

2.Lëvizshmëria e personelit në pajtim me legjislacionin në fuqi brenda SHSK-së është e lejuar, nëse konsiderohet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës.

Neni 26 Shtojcat

Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje është Shtojca 1 e cila përmban emërtimin, klasën dhe grupin e pozitave si dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

Neni 27 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Datë: 14 shkurt 2024

Shtojca Nr.1: ORGANOGRAMI I SHËRBIMIT SPROVUES TË KOSOVËS

Pozicioni/Struktura	Niveli	Grupi (i përgjithshëm ose i veçantë)	Numri
1. Zyra e Drejtorit Ekzekutiv			Totali: 4
-Drejtori Ekzekutiv i Shërbimit Sprovues të Kosovës	Drejtues i lartë 2	N/A	1
- Zyrtar i Lartë për Certifikim	Profesional 1	4.Gr.Specialist i ekonomisë	1
-Zyrtar i Lartë Ekzekutiv	Profesional 1	1. Gr. Specialist ligjor	1
-Zyrtar Administrativ	Profesional 3	58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
2. Departamenti për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative			Totali: 7
- Drejtori i Departamentit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative	Drejtues i mesëm	N/A	1
2.1. Divizioni për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për të Mitur			Totali: 3
- Udhëheqësi i Divizionit për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për të Mitur	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtar i lartë për të mitur	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtar për të mitur	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
2.2. Divizioni për Ekzekutimin e Masave dhe Dënimeve Alternative për Madhor			Totali: 3

- Udhëheqësi i divizionit për ekzekutimin e masave dhe dënimeve alternative për madhor	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtar i lartë për madhor	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtar për madhor	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
3. Departamenti për Mbikëqyrjen e të Liruarve me Kusht, Mbikëqyrje të Posaçme dhe Programe			Totali: 7
- Drejtori i departamentit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht, mbikëqyrje të posaçme dhe programe	Drejtues i mesëm	N/A	1
3.1.Divizioni për Mbikëqyrjen e të Liruarve me Kusht			Totali: 3
- Udhëheqësi i divizionit për mbikëqyrjen e të liruarve me kusht	Drejtues i ultë	N/A	1
-Zyrtar i lartë për lirim me kusht	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtar për lirim me kusht	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
3.2. Divizioni për Mbikëqyrje të Posaçme dhe Programe			Totali: 3
- Udhëheqësi i divizionit për mbikëqyrje të posaçme dhe programe	Drejtues i ultë	N/A	1
-Zyrtar i lartë për mbikëqyrje të posaçme	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar për programe	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1

4. Departamenti për Shërbime të Përgjithshme			Totali: 7
- Drejtori i departamentit për shërbime të përgjithshme	Drejtues i mesëm	N/A	1
4.1 Divizioni për administrimin e shërbimeve të përgjithshme			Totali: 3
- Udhëheqësi i divizionit për administrimin e shërbimeve të përgjithshme	Drejtues i ulët	N/A	1
-Zyrtar i transportit	Profesional 2	58.Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
-Zyrtar i arhivës	Profesional 2	58. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
4.2 Divizioni për Teknologji Informative dhe Bazës së të Dhenave			Totali: 3
-Udhëheqësi i divizionit për teknologji informative dhe bazës së të dhenave	Drejtues i ulët	N/A	1
- Zyrtar i Lartë për TI-së dhe Përkrahje	Profesional 1	19. Gr. Specialist i teknologjisë informative	1
-Zyrtar për Bazën e të Dhënave	Profesional 2	51. Gr. Specialist i bazave të të dhënave	1
5. Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore			Totali: 3
- Udhëheqësi i divizionit për menaxhimin e burimeve njerëzore	Drejtues i ultë	N/A	1
-Zyrtar i Lartë i Personelit	Profesional 1	7.Gr. Specialist i burimeve njerëzore	1
-Zyrtar i Personelit	Profesional 2	7.Gr. Specialist i burimeve njerëzore	1
6. Divizioni për Buxhet dhe Financa			Totali: 3
- Udhëheqësi i divizionit për buxhet dhe financa	Drejtues i ulët	N/A	1

-Zyrtar për buxhet dhe financa	Profesional 2	2.Gr. Specialist financiar	1
-Zyrtar për shpenzime, pasurisë dhe asetëve	Profesional 2	2.Gr. Specialist financiar	1
7. Divizioni Rajonal Prishtinë			Totali: 13
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Prishtinë	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtar i lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	7
- Zyrtar Sprovues	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	4
- Zyrtar administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
8. Divizioni Rajonal Prizren			Totali: 7
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Prizren	Drejtues i ultë	N/A	1
-Zyrtar i lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	2
- Zyrtar Sprovues;	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
-Zyrtar administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	3
9. Divizioni Rajonal Mitrovicë			Totali: 6
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Mitrovicë	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtar i Lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	3
- Zyrtar Sprovues	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtar Administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
10. Divizioni Rajonal Pejë			Totali: 6
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Pejë	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtar i Lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	2

- Zyrtaar Sprovues	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtaar Administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	2
11. Divizioni Rajonal Gjilan			Totali: 6
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Gjilan	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtaar i Lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	2
- Zyrtaar Sprovues	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtaar Administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	2
12. Divizioni Rajonal Ferizaj			Totali: 6
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Ferizaj	Drejtues i ultë	N/A	1
-Zyrtaar i Lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	2
- Zyrtaar Sprovues	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtaar Administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	2
13. Divizioni Rajonal Gjakovë			Totali: 6
- Udhëheqësi i Divizionit Rajonal Gjakovë	Drejtues i ultë	N/A	1
- Zyrtaar i Lartë Sprovues	Profesional 1	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	3
- Zyrtaar Sprovues	Profesional 2	14. Gr. Specialist i shkencave shoqërore	1
- Zyrtaar Administrativ	Profesional 3	64. Gr. Specialist i administrimit të përgjithshëm	1
Totali i numrit të përgjithshëm:			81

Shtojca Nr.2: ORGANOGRAMI I SHËRBIMIT SPROVUES TË KOSOVË

SKEMA ORGANIZATIVE E SHËRBIMIT SPROVUES TË KOSOVËS

